




albanisch / Shqip

## Të nderuar zonja dhe zotërinj,

me punën tuaj në industrinë gjermane të ndërtimit, ju keni marrë përsipër një detyrë shumë të rëndësishme. Ju mundësoni që njerëzit në Bavari të kenë apartamente të reja, të ndërtohen rrugë, shina dhe ndërtesa të rëndësishme.

Në kantierin e ndërtimit ju jeni çdo ditë në kontakt me një numër të madh njerëzish. Kjo është arsyeja pse ju jeni të ekspozuar ndaj një rreziku të madh për t'u infektuar. Nëse infektoheni me koronavirusin, rritet edhe rreziku që ju të infektoni shumë njerëz të tjerë. Këtu ju keni një përgjegjësi të veçantë për koleget/-ët tuaj këtu.



**Prandaj dhe ne, si Ministre e Transportit të Bavarisë dhe Komisionere për Integrimin në Bavari, po ju drejtohem me një kërkesë të madhe: Vaksinohuni.**

Prej disa muaj tashmë kemi vaksina të ndryshme shumë të mira. Përvoja tregon se vaksinimi ul ndjeshëm rrezikun e sëmundjes së koronavirusit dhe të transmetimit të virusit tek të tjerët.

Me miliona njerëz në Gjermani dhe në mbarë botën tashmë janë vaksinuar, edhe ne të dyja.

### Ju mund të vaksinoheni:

- Tek mjeku i familjes
- Në qendrat e vaksinimit (anglisht/gjermanisht): [www.impfzentren.bayern](http://www.impfzentren.bayern)
- Në fushata të ndryshme vaksinimi në të gjithë Bavarinë (anglisht/gjermanisht): [www.stmgp.bayern.de/coronavirus/impfung/#Impfen\\_Aktionen](http://www.stmgp.bayern.de/coronavirus/impfung/#Impfen_Aktionen)
- Në shumë firma dhe kompani. Ndoshta edhe tek ju?

Nëse keni pyetje ose jeni të pasigurtë, atëherë këshillohuni tek mjeku juaj ose na telefononi në numrin pa pagesë 116 117 (shërbim i kujdesit mjekësor).

### Informacion nga Instituti Robert Koch, edhe në gjuhën tuaj amtare, do të gjeni këtu:

- [www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Vektorimpfstoff-Tab.html](http://www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Vektorimpfstoff-Tab.html)
- [www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.htm](http://www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.htm)

Na ndihmoni edhe ju! Koronavirusin mund ta mposhtim vetëm së bashku!



**Kerstin Schreyer**  
Ministre e Shtetit Bavarez për  
Strehimin, Ndërtimin dhe Transportin



**Gudrun Brendel-Fischer**  
Komisionere për Integrimin  
Qeveria e Shtetit Bavarez